

## MEHMET PASHË DERALLA SINONIM I ATDHETARISË DHE SAKRIFICËS KOMBËTARE

**Bujar DUGOLLI**

Të nderuar të pranishëm, familjarë të familjes Deralla, profesorë dhe studiues nga të gjitha viset shqiptare dhe diaspora. Është kënaqësi imja që në kuadër të shënimeve të Festës së Flamurit të nderojmë sot figurën e Mehmet Pashë Derallës. Më duhet të them se Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe posaçërisht Departamenti i Historisë e ka për obligim që të ndriçojë figurën e atdhetarit Mehmet Pashë Deralla, një figurë unike në hapësirat shqiptare. Të paktë janë ata që në historinë shqiptare kanë luftuar me penë e me pushkë, i posaçëm është rasti i gjeneralit Mehmet Pashë Deralla, një figurë e kompletuar dhe e papërsëritshme në historinë tonë.

E nderuar familje Deralla, e kuptoj se keni vuajtur dhe po vuan edhe sot derisa po flasim, pozita juaj nuk është rishikuar për ta pasur vendin e duhur në shoqërinë shqiptare dhe figura e Mehmet Pashë Derallës nuk është e ndriçuar aq sa duhet dhe ju keni plotësisht të drejtë që të jeni të pakënaqur. Por, sot, ne e hapim një cikël të rëndësishëm, duke dashur ta vendosim në vendin e duhur në historiografinë shqiptare figurën e gjyshit tuaj, Mehmet Pashë Derallës, tetovarit i cili luftoi dhe nuk pranoi asnjë kompromis. Në historinë shqiptare ka shumë figura që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm dhe personaliteti i gjyshit tuaj, Mehmet Pashë Deralla, mbetet një figurë e cila tregon më së miri se si duhet vepruar në momente historike dhe të rëndësishme për shqiptarët.

Mehmet Pashë Deralla kërkon si figurë që të studiohet më shumë, të hulumtohet më shumë, të diskutohet më shumë, të nxirren në dritë dokumente me relevancë për rolin e tij, të cilën gjë edhe po e bëjmë sot.

Do ndalem në një moment shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me figurën e Mehmet Pashë Derallës, si ministër i luftës në Qeverinë e Vlorës së 28 Nëntorit 1912. Nuk ka moment më domethënës nga ai kur Ismail Qemali ia lë në dorëzim Qeverinë, në kohën që kërkonte njohjen e Shqipërisë në kancelaritë evropiane. Kjo tregon se sa i madh ka qenë besimi i të parit të Qeverisë shqiptare, Ismail Qemalit, e që flet se Mehmet Pashë Deralla ka qenë figurë unike, e papërsëritshme, në historinë e re shqiptare.

Bashkë me kolegë sot po e nisim një proces të rëndë dhe të vështirë për ta kthyer në vendin e duhur figurën e Mehmet Pashë Derallës, dhe nga këtu them se ne bashkë do punojmë për ndriçimin e punës së këtij atdhetari, të tillë që pak janë në historinë tonë që kanë luftuar edhe me pendë edhe me pushkë për Shqipërinë.